

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.K., nga fsh. ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të dy veprave penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit G.K., të ushtruar kundër aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.828/2016 të dt. 14.11.2016, në seancë ne kolegjit të mbajtur me 08.11.2018 mori këtë :

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet**-si e pabazuar ankesa e të akuzuarit G.K., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.828/2016 të dt. 14.11.2018, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.828/2016 të dt. 14.11.2018, është shpallur fajtor i akuzuari G.K., për shkak të dy veprave penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPK, ashtu që për veprën e parë të përshkruar si ne pikën I të dispozitivit të aktgjykimit i është shqiptuar dënimi më burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dhe dënimi më gjobë në shumë prej 150 (njëqind e pesëdhjete) euro, për veprën penale të përshkruar si ne pikën II të dispozitivit të aktgjykimit i është shqiptuar dënimi më burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dhe dënimi më gjobë në shumë prej 150 (njëqind e pesëdhjete) euro.

Konform nenit 80 par.1 lidhur me par.2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPK-së, gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënim me kusht unik, duke i vërtetuar dënimin më burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe

- dënim më gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin më burgim në kohëzgjatje prej 15 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 €.

Të dëmtuarit Z.K., nga Prizreni dhe përfaqësuesi i autorizuar i marketit ‘N.N.’ për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Është obligur i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari G.K., për shkak të vendimit lidhur më sanksionin penale, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet ose çështja të kthehet në rivendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/II.nr.969/2018, të datës 09.10.2018, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e ushtruar, ka propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

**- Ankesa e të akuzuarit G.K., nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të akuzuarit G.K., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur më sanksionin penal, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë të njëjtit i ka shqiptuar dënim me kusht duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale dhe dënim më gjorbë në shumë prej 300 (treqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin më burgim prej 15 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 euro. Duke pretenduar se gjykata nuk e ka vlerësuar faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar dhe se i njëjti është i gjendjes së varfër ekonomike. Andaj, është dashur që ti vlerësoj këto rrethana e sidomos të vlerësoj faktin se i njëjti është shfrytëzues i ndihmës juridike, andaj në prani të këtyre rrethanave të akuzuarit të lirohet nga dënimi më gjorbë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, ashtu që kolegji pas vlerësimit të

aktgjykimit, vie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale, se i njëjti është penduar për veprën e kryer penale dhe faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje për rastin që ka ndodhur, se është baba i tre fëmijëve, se është i gjendjes së varfër ekonomike dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të bie në kundërshtim me ligjin, gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese e sidomos ka pasur parasysh intensitetin e kryerjes së veprës penale, andaj, në prani të këtyre rrethanave, e duke mos gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, sikur se pretendon i akuzuari në ankesë, kolegji i kësaj gjykatë, është i bindur se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës shkallës parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.963/2018, të datës 08.11.2018**

**B.profesionale**  
**Leonita Lajçi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Biljana Rexhiq**